



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 655, Datë 01.11.2019

“Për disa ndryshime në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 643, datë 25.07.2019, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit ndaj ndërmarrjeve “Agroblend”, “Miell Tirana”, “Bloja” dhe “Atlas””

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 01.11.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për disa ndryshime në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 643, datë 25.07.2019, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit ndaj ndërmarrjeve “Agroblend”, “Miell Tirana”, “Bloja” dhe “Atlas””.

Baza Ligjore: Neni 4 dhe 9, Neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 43, pika 1, i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji nr. 9121/2003).
Neni 112 i Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi disa ndryshime në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 643, datë 25.07.2019, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit ndaj ndërmarrjeve “Agroblend”, “Miell Tirana”, “Bloja” dhe “Atlas””,

VËREN SE :

1. Me vendimin nr. 551, datë 04.10.2018, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit”, të ndryshuar, Komisionit të Konkurrencës vendosi hapjen e hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit për periudhën kohore nga 1.1.2017 deri në 30.09.2018.

2. Në përfundim të hetimit rezultoi se, në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit, mund të ketë elementë të cilat mund të përbëjnë shkelje të konkurrencës apo sjellje të bashkërenduar nga ndërmarrjet që zënë peshën kryesore në treg “AGROBLEND” dhe “MIELL TIRANA”, “BLOJA” dhe “ATLAS”.
3. Bazuar sa me sipër, me vendimin nr. 643, datë 25.07.2019, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit ndaj ndërmarrjeve “Agroblend”, “Miell Tirana”, “Bloja” dhe “Atlas”, Komisioni i Konkurrencës vendosi hapjen e hetimit të thelluar ndaj këtyre ndërmarrjeve në tregun përkatës. Hetimi i thelluar përfshin periudhën kohore nga 01.01.2018 deri në 30.06.2019.
4. Gjatë procedurës së hetimit të thelluar, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 9121/2003 me qëllim mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, është kërkuar informacion nga ndërmarrjet nën hetim.
5. Nga administrimi i informacionit u konstatua se në ndërmarrjen nën hetim Atlas SHA, e cila ka ushtruar veprimtarinë ekonomike në tregun e përpunimit dhe tregtimit të miellit, ka ndodhur transferimi i biznesit (veprimtarisë ekonomike) të përpunimit dhe tregtimit të miellit tek ndërmarrja Atlas Mills SHPK, konkretisht me vendim e datës 03.09.2018 të Asamblesë së Përgjithshëm të shoqërisë Atlas SHA. Atlas Mills SHPK është krijuar si një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar me ortak të vetëm Dimitrios Thomoglou, aksioner i vetëm edhe i ndërmarrjes Atlas SHA.
6. Në datë 28 Shtator 2018, zotëruesit e shoqërive Atlas Mills SHPK dhe Besniku SHPK, kanë lidhur marrëveshjen “Kontratë Shitje Kuotash”, ku Z. Dimitrios Thomoglou (shitësi), në cilësinë e pronarit të “kuotës” së kapitalit të shoqërisë Atlas Mills SHPK i shet shoqërisë Besniku SHPK (blerësi) kuotën e vetme të kapitalit të shoqërisë Atlas Mills SHPK.
7. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 622, datë 13.05.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 100% të kuotave të shoqërisë Atlas Mills SHPK nga shoqëria Besniku SHPK”, ka vendosur të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së 100 % të kuotave të shoqërisë Atlas Mills SHPK nga shoqëria Besniku SHPK.
8. Sa më sipër, ndërmarrja Atlas Mills SHPK nga data 28.09.2018 ka kaluar në pronësi të shoqërisë Besniku SHPK, gjë e cila nënkupton faktin që ndërmarrja Atlas SHA nga ky moment nuk operon më në tregun e prodhimit (përpunimit) dhe tregtimit të miellit.
9. Si përfundim rezulton se, gjatë periudhës nën hetim 01.01.2017 deri në 30.06.2019, në tregun objekt hetimi operojnë të dyja ndërmarrjet Atlas SHA me aksionar z. Dimitrios Thomoglou dhe Atlas Mills SHPK me ortak të vetëm shoqërinë Besniku SHPK, duke bërë të nevojshme përfshirjen e të dyja këtyre ndërmarrjeve nën hetim.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 43, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 643, datë 25.07.2019, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit ndaj ndërmarrjeve “Agroblend”, “Miell Tirana”, “Bloja” dhe “Atlas”, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
 - a. Objekti i hetimit të ndryshohet si vijon: “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit ndaj ndërmarrjeve “Agro Blend” SHPK, “Miell Tirana” SHA, “Bloja” SHA, “Atlas SHA” dhe “Atlas Mills” SHPK”;
 - b. Pika 1 e dispozitivit të ndryshohet si vijon: “Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit ndaj ndërmarrjeve “Agro Blend” SHPK, “Miell Tirana” SHA, “Bloja” SHA, “Atlas SHA” dhe “Atlas Mills” SHPK”;
 - c. Në pikën 2 të dispozitivit periudha kohore: “nga 01.01.2018” bëhet “nga 01.01.2017”.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS